

Bsc.Erduan RASHICA

Alternative Dispute Resolution

ADR

TRANSPORTI I MATERIEVE TË RREZIKSHME

1.DEFINIMI DHE KLASIFIKIMI I MATERIEVE TË RREZIKSHME

Si materie të rrezikshme konsiderohen ato materie të cilat gjatë prodhimit, trajtimit, transportit, shpërndarjes apo përdorimit mund të shkaktojnë rrezik ndaj shëndetit të njerëzve, të mirave materiale ose ta ndotin ambientin.

Materiet e rrezikshme (ADR) ndahen në nëntë klasa edhe atë:

Klasa 1: Materiet eksplozive

Këtë klasë e përbëjnë materiet e ngurta dhe të lëngëta kimike të cilat kanë vetinë që gjatë veprimit të mjedisit jetësor (goditje - fërkim) me zbërthim eksploziv kimik të lirojnë energji në formë të nxehtësisë apo të gazeve. Rezultati i këtij zbërthimi është krijimi i presionit të lartë dhe temperaturës së lartë. Në grupin e materieve eksplozive përfshihen mjete për ndezjen e eksplozivëve, masa e papërpunuar e barotit, municioni komercial, nitroceluloza, artikuj piroteknik etj.



Fig.1. Klasa 1. Eksplozivëve

Klasa 2: Gazet

Këto gaze kanë temperaturë kritike më të ulët se 50 °C. Të lidhura me oksigjenin digjen në praninë e burimi ndezjes. Karakteristika kryesore e të gjitha gazeve të cilat transportohen, është ajo se ato janë të ngjeshura në hapësirë nga e cila tentojnë të dalin jashtë. Presioni i gazeve të cilat janë në enët në të cilat transportohen, e përfaqësojnë edhe rrezikun kryesor nga materiali i kësaj klase. Gazet të cilat transportohen, zakonisht janë të vendosura në enë cilindrike, për shkak të transportit më ekonomik dhe më të sigurt. Efekti i këtyre gazeve mund të jetë helmues, i ndezshëm, korroziv dhe ngulfatës.



Fig.2. (2.1). Klasa 2. Gazet të ndezshme



Fig.3. (2.2). Klasa 2. Gazet të ndezshme



Fig.4. (2.3). Klasa 2. Gazet të ndezshme

Klasa 3: Lëngjet ndezëse

Ato janë lëngje ose përzierje të lëngjeve të cilat në temperaturë prej 50 °C kanë presion të avullit më të ulët se 3 barë dhe pikën e ndezjes më të ulët se 100 °C. Avujt e tyre në kontakt me ajrin ndizen lehtë. Automjeti transportues me të cilin transportohen lëngjet e ndezshme gjatë ngarkimit, shkarkimit ose ringarkimit mund të derdhen në tokë dhe gypi fryrës të jetë shkaktar ndezës. Motori dhe pajisjet për ngrohje të kabinës patjetër duhet të jenë të shkyçura.



Fig.5. Klasa 3. Lëngje të ndezshme

Klasa 4: Materiet e ngurta ndezëse

Ato janë materie të ngurta të cilat, kur janë të thata, lehtë ndizen në kontakt me flakën ose shkëndijën, por nuk janë të prira në ndezje (sulfuri, fosfori i kuq).

Klasa 4 e materieve të rrezikshme është e ndarë në tri nëngrupe të cilat janë si më poshtë:

Klasa 4.1: Materiet të cilat lehtë digjen

Në këtë klasë përfshihen materiet që digjen lehtë dhe shfaqen në formën e pluhurit, por edhe mund të shkrihen. Disa materie të kësaj klase vetë zbërthehen dhe për këtë arsye duhet të transportohen në kushte të temperaturës dhe presionit të kontrolluar. Shembuj të materieve të rrezikshme nga kjo klasë janë pluhuri i aluminit, goma e papërpunuar, sulfuri, fosfori i kuqe etj.



Fig.6. Klasa 4.1. Materiet të cilat lehtë digjen

Klasa 4.2: Materiet të prira ndaj vetëndezjes spontane

Në këtë klasë përfshihen materiet organike dhe inorganike të cilat janë të prira ndaj vetëndezjes spontane. Respektivisht, që të ndizen nuk është i nevojshëm burim i jashtëm. Shembull i materieve të rrezikshme nga kjo klasë janë fosfori i bardhë dhe i verdhë, qymyri aktiv, pambuku i lagur etj.



Fig.7. Klasa 4.2. Materiet të prira ndaj vetëndezjes spontane

Klasa 4.3: Materiet të cilat në kontakt me ujin krijojnë gaze të ndezshme

Në këtë klasë përfshihen materieve të cilat në kontakt me ujin lëshojnë gaze të ndezshme të cilat formojnë përzierje shpërthyese në kontakt me oksigjenin dhe ajrin. Shembuj të materieve të rrezikshme nga kjo klasë janë natriumi, kalciumi, metalet alkale e të tjera.



Fig.8. Klasa 4.3. Materiet të cilat në kontakt me ujin krijojnë gaze të ndezshme

Klasa 5: Oksidet dhe peroksidet organike

Materiet oksiduese janë ato të cilat në kontakt me materie të tjera zbërthehen dhe mund të shkaktojnë zjarr (p.sh. kloridet, tretjet ujore të hidrogjenit etj.).

Klasa 5.1: Oksidet

Këto janë materie organike me një shkallë të lartë të oksidimit të cilat mund të shkaktojnë efekte të dëmshme ndaj shëndetit të njeriut. Janë të ndjeshme ndaj rritjes së temperaturës dhe goditjeve kur ato mund të shpërthejnë. Prandaj këto materie të rrezikshme nuk duhet të përzihen me materie të tjera të rrezikshme, të kihet kujdes që të mos fërkohen dhe të mos ekspozohen ndaj goditjeve.



Fig.9. Klasa 5.1. Oksidet

Klasa 5.2: Peroksidet organike

Në përbërjen e këtyre materialeve ekziston oksigjeni dhe elementet djegëse të cilat ndizen lehtë, që do të thotë se nuk kanë nevojë për burimet e jashtme të oksigjenit ose të ndezësve që të ndizen. Në këtë klasë përfshihen dibenzol peroksidi, acidi peroksid e tjera.



Fig.10. Klasa 5.2. Peroksidet organike

Klasa 6: Materiet helmuese dhe infektive

Materiet e rrezikshme nga kjo klasë janë të ndara në dy nënklasa edhe atë:

Klasa 6.1: Materiet helmuese

Helmet janë materie me origjinë sintetike, natyrore ose biologjike të cilat të futura në organizmin e njeriut mund të rrezikojnë shëndetin dhe t'i çrregullojnë funksionet e organizmit. Për një kohë të shkurtër dhe në sasi të vogla mund të dëmtojnë shëndetin e njeriut dhe të shkaktojnë edhe vdekje. Helmet i sulmojnë organet e brendshme dhe sistemin nervor, e për këtë shkak nevojitet kujdes për trajtimin dhe manipulimin e tyre.



Fig.11. Klasa 6.1. Materiet helmuese

Klasa 6.2: Materiet infektive

Në këtë klasë përfshihen materiet të cilat përmbajnë mikroorganizma siç janë bakteret, viruset, parazitët etj. Mbeturinat dhe materiet infektive përhapin erë të pakëndshme dhe përmbajnë toksina. Në kontakt me to, mund të shkaktojnë sëmundje infektive te njerëzit dhe kafshët. Prandaj materiet e rrezikshme nga kjo klasë nuk duhet të transportohen me produkte ushqimore të destinuara për njerëzit dhe kafshët.



Fig.12. Klasa 6.2. Materiet infektive

Klasa 7: Materiet radioaktive

Këto janë materie të cilat përmbajnë atome radioaktive. Radioaktiviteti është aftësi që bërthama e atomit spontanisht të zbërthehet, d.m.th. ai është proces gjatë të cilit bërthama zbërthehet në ndonjë element duke liruar grimca alfa dhe beta ose rreze gama. Materiet radioaktive i dëmtojnë organizmat e gjallë varësisht nga ajo se në çfarë doze dhe sa kohë janë ekspozuar ndaj tyre. Materiet radioaktive përdoren në mjekësi për regjistrime të ndryshme të eshtrave, në energjetikë si burim i energjisë termike, në industrinë për kontroll të cilësisë së materialeve etj. Ambalazhi, me të cilin pakëtohet materia radioaktive duhet të bëhet në mënyrë që mund të parandalohet përhapja e rrezatimit. Shembuj tipikë të materieve radioaktive janë uranumi, ceziumi dhe toriumi.



Fig.13. Klasa 7. Materiet radioaktive

Klasa 8: Materiet korrozive

Materiet korrozive janë materie të cilat në kontakt me materie të tjera dhe organizma të gjallë shkaktojnë dëme ose shkatërrim të tyre. Ato i shkatërrojnë qelizat e organizmave të gjallë, d.m.th. i hanë materiet jo të gjalla. Shembuj të materieve korrozive janë acidi nitrik, sulfurik dhe klorhidrik, materiet alkale etj. Materiet korrozive mund të transportohen në gjendje të ngurtë ose të lëngët.



Fig.14. klasa 8. Materiet korrozive

Klasa 9: Materiet tjera të rrezikshme

Materie të tjera të rrezikshme janë materiet të cilat vetë më vete gjatë transportit paraqesin rrezik të caktuar dhe nuk i përkasin ndonjë klase tjetër. Shembuj të këtyre materieve janë materiet të cilat mund të rrezikojnë shëndetin gjatë frymëmarrjes, materie të cilat lëshojnë gazra të ndezshme, bateritë e litiumit, jastëkët e ajrit, xhaketat shkëlqyese, fishekzjarrët etj.



Fig.15.Klasa 9. Materiet tjera të rrezikshme

Klasat e materieve të rrezikshme dhe etiketat e tyre janë treguar në figurën numër 16.




Fig. 16. Klasat e materieve të rrezikshme

2.RREGULLAT GJATË TRANSPORTIT TË MATERIEVE TË RREZIKSHME

Ndërmarrjet autotransportuese dhe personat tjerë juridikë dhe fizikë të cilët përgatitin materie të rrezikshme për transport ose kryejnë ngarkim, shkarkim dhe ringarkim, duhet të marrin masa parandaluese dhe mbrojtëse për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e njerëzve, mjedisin jetësor, të mirat materiale dhe sigurinë e trafikut.

Prandaj, nevojitet trajnim i organizuar dhe profesional i shoferëve të automjeteve të mallrave me të cilat transportohen materialet e rrezikshme, si dhe të gjithë personave të tjerë të përfshirë në transportin dhe manipulimin e tyre.

Transporti i materieve të rrezikshme në Republikën e Maqedonisë është përfshirë me më shumë ligje dhe rregullore:

- ❖ *Ligji për transportin e materieve të rrezikshme;*
- ❖ *Rregullorja për mënyrën e transportit të materieve të rrezikshme në trafikun rrugor;*
- ❖ *Rregullorja për aftësim profesional të vozitësve të automjeteve motorike me të cilat transportohen materialet e rrezikshme dhe personave të tjerë të cilët marrin pjesë në transportin e materieve të rrezikshme;*
- ❖ *Ligji për mbrojtjen e materieve eksplozive;*
- ❖ *Ligji për tregti me materie eksplozive;*
- ❖ *Ligji për prodhimin e helmeve dhe*
- ❖ *Ligji për tregti me helmet.*

Qëllimi kryesor i trajnimit special të shoferëve të automjeteve të rënda të cilat transportojnë materie të rrezikshme, përbëhet në njohjen e karakteristikave të transportit individual të materieve të rrezikshme dhe për të gjetur njohuri themelore të nevojshme për të zvogëluar mundësitë për raste të rrezikshme dhe aksidente.




Fig. 17. Rregulla e vendosjes së shenjave të ADR – së




Fig.18. Përmbajtja e disa materieve të rrezikshme në mjetin transportues

3.DOKUMENTET PËR TRANSPORT TË MATERIEVE TË RREZIKSHME

Dërguesi i cili jep transport për mallra të rrezikshme është i obliguar që për çdo dërgesë të materieve të rrezikshme t'i japë transportuesit dokumentin për transport dhe udhëzimin për masa të veçanta të sigurisë që duhet të merren gjatë transportit të materieve të rrezikshme. Dokumenti për transportin e materieve të rrezikshme duhet të përmbajë:

1. Të dhënat për përmbajtjen e dërgesës (treguesi i llojit të mallrave, vetitë kimike dhe teknike, emri i materieve të rrezikshme, pesha, numri i copave, numri i identifikimit nga marrëveshja përkatëse ndërkombëtare etj.).
2. Shënimin e dërguesit se janë të plotësuara kushtet e përcaktuara për transportin e materieve të rrezikshme.
3. Emrin, ose emrin personal dhe adresën e dërguesit dhe marrësit.
4. Vërejtjen se me dokumentin për transport të materieve të rrezikshme transportuesit i është dhënë edhe udhëzimi me shkrim për masa të posaçme të sigurisë që duhet të ndërmerren gjatë transportit të

materieve të rrezikshme.

5. Nënshkrimin dhe vulën e dërguesit.

Dokumenti për transportin e materie të rrezikshme të cilat dërgohen jashtë shtetit duhet të jetë i shkruar në anglisht, frëngjisht, rusisht dhe gjermanisht. Dokumenti për transport përbëhet nga tri kopje identike: një mbetet te dërguesi, një i jepet transportuesit dhe një i dorëzohet marrësit të materies së rrezikshme.

Shoferi duhet të ketë:

- ➔ *dokumentin, faturën e ngarkimit;*
- ➔ *certifikatën e rregullshmërisë së mjetit motorik;*
- ➔ *certifikatën e trajnimit profesional dhe*
- ➔ *udhëzuesin për masat e veçanta të sigurisë.*




D ADR-SCHULUNGSBESCHEINIGUNG ADR FÜR FAHRZEUGFÜHRER	
	<ol style="list-style-type: none">1. 999-999-1234567892. Mustermann3. Max4. 01.01.19705. deutsch6.  Unterschrift Fahrzeugführer/in7. Bundeswehr8. gültig bis: 01.01.2013
GÜLTIG FÜR KLASSE(N) ODER UN-NUMMERN:	
IN TANKS	AUSGENOMMEN IN TANKS
9. 1, 2, 3, 4.1, 4.2, 4.3, 5.1, 5.2, 6.1, 6.2, 7, 8, 9	10. 1, 2, 3, 4.1, 4.2, 4.3, 5.1, 5.2, 6.1, 6.2, 7, 8, 9
	

Fig.19. Certifikata biometrike e ADR – së




Fig.20. Certifikata e ADR – së

Në transportin ndërkombëtar transporti i materieve të rrezikshme është rregulluar sipas rregullave dhe rregulloreve të caktuara. Këto rregulla janë rregulluar sipas ADR - Konventës Evropiane për Transport Ndërkombëtar të materieve të rrezikshme në trafikun rrugor. Të gjitha shtetet anëtare të kësaj Konvente, duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës, patjetër duhet t'i respektojnë rregullat e Konventës.

Kjo konventë është arritur në Gjenevë më 30.08.1957, nën kryesinë e Komisionit Ekonomik për Evropën të Kombeve të Bashkuara dhe ka hyrë në fuqi më 29.01.1968.

Përmban dy anekse, edhe atë aneksin A dhe aneksin B. Këto anekse janë publikuar në dy vëllime në të ashtuquajturin “*Libri i portokalltë*”. Vetë marrëveshja është shumë e shkurtër, e qartë dhe e thjeshtë. Kryesor është neni i dytë, i cili thotë se me përjashtim të disa mallrave të rrezikshme, të gjitha mallrat e tjera të rrezikshme mund të transportohen në rrugët ndërkombëtare me kamionë të cilët i plotësojnë kushtet për:

Në aneksin A:

- 1. klasifikimi i të gjitha materieve të njohura të rrezikshme;*
- 2. kushtet për etiketim dhe paketim;*
- 3. lista e materieve të rrezikshme dhe sasisë e kufizuara;*
- 4. përdorimi i kontejnerëve, paketimeve dhe cisternave;*
- 5. procedurat për transport;*

6. kushtet për konstruktimin dhe testimin e paketimeve, kontejnerëve dhe cisternave;
7. kushtet për transport, ngarkim, shkarkim dhe përdorim.

Në aneksin B:

1. kushtet për konstruksion, pajisje dhe operacione me automjete;
2. ekuipazhi dhe lejimi i automjeteve.

Çdo materie e rrezikshme është deklaruar me numër të vetëm katërshifror, numër i Kombeve të Bashkuara - UN-numri, me të cilin është mundësuar identifikimi ndërkombëtar i materieve të rrezikshme.


4.PAJISJET E AUTOMJETEVE DHE SHOFERËVE PËR TRANSPORT TË MATERIEVE TË RREZIKSHME

Ligji për transportin e materieve të rrezikshme parashikon se automjeti motorik i cili transporton mallra të rrezikshme, përveç pajisjeve të parashikuara me rregulloret e përgjithshme dhe me Marrëveshjen Evropiane për transport ndërkombëtar të materieve të rrezikshme në trafiku rrugor, duhet të posedojë edhe pajisje të mëposhtme:

1. Mjete dhe vegël për ngritjen e automjetit;
2. Së paku dy aparate për shuarjen e zjarrit, prej të cilave njëri për shuarjen e zjarrit në motor, kurse tjetri për shuarjen e zjarrit të mallit në automjet, edhe 3 kg dhe 6 kg (të treguar në figurën numër 30);
3. Dy llamba dore elektrike me dritë dridhëse ose të vazhdueshme me ngjyrë portokalli;
4. Dy trekëndësha, me te cilat do të tregohet automjeti motorik i ndalur në rrugë;
5. Dy flamuj të vegjël të cilët do të tregojnë automjetin motorik i cili transporton materie të rrezikshme;
6. Dy lopata dhe një kazmë;
7. Llambë bartëse e cila mund të kyçet në baterinë e automjetit dhe e cila është bërë në mënyrë që të mos mund të shkaktojnë zjarr dhe
8. Direkt i kyçur në automjetin motorik mund të jetë vetëm takografi.



Fig.21. Pajisje e automjeteve për transportin e materieve të rrezikshme (aparati kundra zjarrit)



Automjetet të cilat bëjnë transportin e materieve të rrezikshme, respektivisht cisternat, janë treguar në figurat e mëposhtme numër 22 dhe 23.



Fig.22. Cisterna për transportin e materieve të rrezikshme



Fig.23. Cisterna – kontejner

Shoferët e automjeteve që transportojnë materie të rrezikshme duhet të jenë të furnizuar me pajisje të përshtatshme personale mbrojtëse. Pajisja minimale personale mbrojtëse, të cilën duhet ta kenë shoferët, është si vijon:

1. *kapela mbrojtëse;*
2. *syze mbrojtëse me mbrojtje anësore;*
3. *dorëza gome;*
4. *çizme apo këpucë mbrojtëse me maja çeliku;*
5. *jelek sinjalizues me shirita fluoreshente;*
6. *llambë dore me trup plastik ose alumini;*
7. *veshje të atestuar për mbrojtje nga elektriciteti statik, nëse transportohen lëndë eksplozive;*
8. *lëng për shpëlarjen e syve, në qoftë se transportohen materie korrozive;*
9. *maska mbrojtëse me filtra të përshtatshëm gjatë transportit të materieve helmuese ose infektive.*

5. TRANSPORTI I MATERIEVE TË RREZIKSHME

Kompanitë dhe personat e tjerë juridikë dhe individët të cilët japin për transport materieve të rrezikshme ose e transportojnë me automjete të veta transportuese, janë të detyruar ta përgatisin atë në mënyrë që t'i plotësojë të gjitha kushtet e përcaktuara për transportin e tyre.

Materiet e rrezikshme nuk duhet të jepen për transport, nëse nuk plotësohen kushtet e përcaktuar për transport. Automjetet me të cilat transportohen materiet e rrezikshme duhet të jenë teknikisht në rregull dhe të ndërtuara dhe të pajisura në atë mënyrë që në kushte normale të transportit të sigurojnë transport të sigurt. Automjetet me të cilat transportohen materiet e rrezikshme duhet të jenë të etiketuara dhe të shënuara në mënyrë të përcaktuar me Ligj për materie të rrezikshme dhe me marrëveshje ndërkombëtare për transport të materieve të rrezikshme për degë të caktuara të trafikut. Në valixhen e dorës nuk duhet të transportohen materie të rrezikshme. Mund të mbahen aparate, pajisje dhe mjete të tjera të ngjashme që përmbajnë sasi minimale të materieve të rrezikshme të cilat nuk paraqesin rrezik për mjedisin, kurse shërbejnë për përdorim personal (shkrepëse, ngjyra, vernikë, etj).

Kompanitë dhe personat e tjerë juridikë dhe individët të cilët transportojnë materie të rrezikshme janë të detyruar që në rastin e zhdukjes së materies së rrezikshme gjatë transportit të ndërmarrin masa të veçanta për gjetjen e tyre. Me këtë rast, duhet ta informojnë organin më të afërt të

inspeksionit sanitar ose stacionin më të afërt policor, por sipas mundësisë edhe opinionin.

Materiet e rrëzuara ose në çfarëdo mënyre qoftë materiet e derdhura të rrezikshme gjatë transportit, transportuesi është i obliguar t'i mbledhë dhe t'i heqë, respektivisht t'i derdhë në vendet e caktuara për atë ose në një mënyrë tjetër t'i bëjë të parrezikshme. Materiet e rrezikshme nuk duhet të transportohen në hapësirë të njëjtë të ngarkesës me produktet shtazore, me ushqimin e kafshëve, ilaçet dhe artikujt për përdorim të përgjithshëm që i nënshtrohet mbikëqyrjes shëndetësore.



Fig.24. Vendosja e materies se rrezikshme për transport

6.MASAT E NEVOJSHME TË SIGURISË PËR TRANSPORT TË MATERJEVE TË RREZIKSHME

Gjatë transportit të materieve të rrezikshme në komunikacionin rrugor,

përveç masave të sigurisë për transport të materieve të rrezikshme siç është përcaktuar me ligj, do të zbatohen dispozitat e Marrëveshjes Evropiane në lidhje me transportin ndërkombëtar të materieve të rrezikshme në trafikun rrugor. Në automjetet motorike me të cilat transportohen materiet e rrezikshme nuk duhet të gjenden njerëz të tjerë, përveç shoferit, bashkëshoferit dhe shoqëruesit. Në automjetit që transporton mallra të rrezikshme nuk duhet të mbahen materie që shkaktajnë zjarr, nuk duhet të kryhen riparime etj. Shoferi është i detyruar ta drejtojë automjetin me kujdes të madh. Shpejtësia e lëvizjes së automjeteve motorike nuk duhet të tejkalojë 80% nga shpejtësia e lejueshme maksimale e përcaktuar nga lloji i rrugës, ose e përcaktuar nga shenjat e trafikut të vendosura në rrugë. Në asnjë rast shpejtësia nuk guxon të jetë më e madhe se 70 km/h.

Udhëzimi për masat e veçanta të sigurisë që duhet të ndërmerren gjatë transportit të materieve të rrezikshme duhet të përfshijë:

- 1. Përcaktimin e llojit të rrezikut që e paraqet dhe pasojat që mund të shkaktajnë materiet e rrezikshme;*
- 2. Caktimin e masave të posaçme që duhet të ndërmerren gjatë transportit të materieve të rrezikshme dhe masave për të parandaluar ose për të zbutur pasojat e dëmshme që mund të paraqiten për shkak të aksidentit apo fatkeqësisë së automjeteve (zjarri, thyerja e ambalazhit, rrëzimet apo derdhjet e materies së rrezikshme, etj);*
- 3. Procedurën me personin që do të vijë në kontakt me materiet e rrezikshme;*
- 4. Emrin dhe adresën e kompanisë ose organit i cili patjetër duhet të lajmërojë aksidentin ose fatkeqësinë që ka ndodhur gjatë transportit të materieve të rrezikshme. Transportuesi dhe personi që drejton automjetin transportues të materieve të rrezikshme janë të detyruar që në dokumentin e transportit të materieve të rrezikshme me nënshkrimin e tyre të konfirmojnë pranimin e materies së rrezikshme për transport.*

7.SHENJAT E AUTOMJETEVE MOTORIKE PËR TRANSPORTIN E MATERIEVE TË RREZIKSHME

Automjetet motorike me të cilat transportohen materialet e rrezikshme patjetër duhet të kenë drita dhe shenja të veçanta:

- 1. Dy drita të rrumbullakëta portokalli me diametër të sipërfaqes së dritës të paktën 10cm të vendosura në kulmet e sipërme të automjetit.*

2. Dy drita të rrumbullakëta të kuqe në të gjithë sipërfaqen e dritës të vendosura 10cm në kulmet e sipërme në anën e pasme të automjetit;
3. Dy shenja për të treguar automjetin që transporton materie të rrezikshme të shkruara me numrat e identifikimit të materieve të rrezikshme që transportohen. Dritat nga pika 1 dhe 2 duhet të jenë ndezura në qoftë se materiet e rrezikshme transportohen në muzgun e parë deri në agimin e plotë, si dhe gjatë zvogëlimit të shikimit, si dhe gjatë kohës të shikimit të zvogëluar për shkak të kushteve atmosferike dhe të tjera.

Ato duhet të jenë të ndezura edhe kur në automjetin motorik është dezur cilado qoftë dritë për ndriçim të rrugës apo dritë për të treguar automjetin. Shenja për të treguar automjetin, me të cilin transportohen materie të rrezikshme, numri i identifikimit të disa materieve të rrezikshme dhe vendi i vendosjes së shenjave të automjeteve patjetër duhet të bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Marrëveshjes Evropiane për transport ndërkombëtar të materieve të rrezikshme në komunikacionin rrugor. Automjeti motorik dhe rimorkio, me të cilat transportohen materie të rrezikshme duhet të kenë pajisje për përcjellje statike të energjisë elektrike. Shenjat në automjetet transportuese të materieve të rrezikshme janë të paraqitura në figurat numër 25 dhe 26.




Fig. 25. Shenjat e automjeteve për transport të materieve të rrezikshme



Fig.26. Shenjat e automjeteve dhe ngarkesave për transport të materieve të rrezikshme

Gjatë transportit të materieve të rrezikshme, është e detyrueshme që automjeti në anën e tij të përparme dhe të pasme të jetë shënuar me shenja të përshtatshme të paralajmërimit. Tabelat me të cilat bëhet shënimi i automjeteve motorike në janë me ngjyra portokalli, me formë drejtkëndëshe dhe me madhësi 400 x 300mm dhe brinjë të zeza me gjatësi maksimale prej 15mm me dy fusha (të treguar në figurat nr. 27, 28 dhe 29). Në fushën e sipërme është shkruar shenja numerike e rrezikut dhe në fushën më poshtë shenja numerike e materieve të rrezikshme (4 shifra).



Fig.27. Tabela e Kemplerit



Fig.28. Tabela e Kemplerit




Fig.29. Shenjat e automjeteve motorike për transportin e materieve të rrezikshme

Shenja numerike e rrezikut (numri i lartë) **NUMRI I KEMPLERIT**, përbëhet prej numrave dhe shenjave.

Shifra e parë tregon rrezikun kryesor si vijon:

2. - *Gazi*
3. - *Materiet e lëngshme të ndezshme*
4. - *Materiet e ngurta të ndezshme*
5. - *Materiet oksiduese dhe peroksidet organike*
6. - *Materiet helmuese*
8. - *Materiet korrozive*

Shifra e dytë dhe e tretë e tregojnë rrezikun shtesë ose intensitetin e reagimit. 0 - Pa kuptim

1. - *Rreziku i shpërthimit*
2. - *Lirimin e gazit për shkak të presionit ose reagimeve kimike*
3. - *Lëngjet e ndezshme ose gazet*
5. - *Veprimi oksidues*
6. - *Hemlueshmëria*
8. - *Korroziteti*
9. - *Rreziku nga reagimi spontan i energjisë gjatë zbërthimit*

Nëse dy shifra janë të njëjta, do të thotë se rreziku kryesor është shumë i shprehur. Shembull:

33. - *Lëngu që ndizet lehtë*
66. - *Materia mjaft helmuese*
88. - *Materia mjaft korrozive*
42. - *Materia e ngurta e cila në kontakt me ujin liron gaz*

Nëse para numrit të identifikimit qëndron shkronja X, kjo do të thotë se materiet e rrezikshme **NUK DUHET TË VIJNË NË KONTAKT ME UJIN**, as edhe në rast të zjarrit dhe aksidenteve të automjetit ose të ngarkesës.

H323 – Lëngu që ndizet lehtë i cili reagon me ujë liron gaz të ndezshëm;

H338 - Lëngu që ndizet lehtë, korroziv, i cili reagon rrezikshëm në kontakt me ujin; H333 – Lëngu që ndizet vetë në kontakt me ujin reagon dhe liron gaze të djegshme.

Shënimi bëhet me letër vetëngritëse me shenja të sterilizuara të rrezikut me format standard A5, e cila duhet të ngjitet në të gjitha paketat e veçanta.

8. PROCEDURA NË RAST TË DEFEKTIT OSE AKSIDENTIT TË TRAFIKUT

Sigurimi i transportit të sigurt është faktor i rëndësishëm, i cili është subjekt i hulumtimeve, analizave dhe planifikimeve të ndryshme. Për përmirësimin e klimës për transport të sigurt të materieve të rrezikshme marrin pjesë të gjitha palëve e interesuara, pjesëmarrësit në transport dhe trafik. Përveç masave të miratuara ligjore për sigurinë e trafikut dhe transportit, të cilat duhet të respektohen, nevojiten edhe masa shtesë për mbrojtjen e njerëzve dhe pronës gjatë transportit. Kërkesat e parashtruara për drejtimin e automjetit motorik i cili transporton mallra të rrezikshme ose bën ngarkim dhe shkarkim janë dukshëm më të mëdha se sa transporti i mallrave të tjera. Kjo është kryesisht për shkak të pasojave që mund të ndodhin në rast aksidenti ose fatkeqësie. Midis situatave të mundshme negative që do të ndodhin në një rast të tillë janë derdhjet e lëngjeve, helmimi, ndotja e mjedisit, rreziqet për shëndetin e njerëzve dhe të mirave materiale etj.

Faktorët kryesorë që kontribuojnë në paraqitjen e një aksidenti gjatë transportit janë njeriu, automjeti dhe rruga. Por shkaqe më të zakonshme të aksidentet janë:

- ➔ *mënyra në të cilën shoferi e drejton automjetin gjatë drejtimit të automjetit;*
- ➔ *siguria teknike e automjetit të destinuar për transport;*
- ➔ *lloji dhe sasia e mallrave;*
- ➔ *kushtet e motit;*
- ➔ *rruga e infrastrukturës rrugore;*
- ➔ *shfrytëzuesit e tjerë të rrugës;*
- ➔ *dështimi në përputhje me rregullat dhe rregulloret për kryerjen e ngarkimit, ringarkimit ose shkarkimit;*
- ➔ *ndalimi i mjetit në vendin jo të duhur pa vendosjen e duhur të shenjave dhe sinjaleve paralajmëruese etj.*

Prandaj, të gjithë personat që manipulojnë me materiet e rrezikshme duhet të kenë kryer trajnimin për përdorimin e tyre për të parandaluar dhe zvogëluar aksidentet e trafiku.

Shoferi që e drejton automjetin motorik i cili transporton materie të rrezikshme, në rast të defektit apo aksidentit, ose për shkaqe të tjera të arsyeshme do ta ndalë automjetin. Me këtë rast duhet t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të mos i rrezikojë automjetet e tjera dhe të

paralajmërojë të gjithë pjesëmarrësit e tjerët në trafik.

Shoferi duhet të ndërmarrë masat e mëposhtme:

1. *Ditën dhe natën prapa automjetit të ndalur të vendosë dy shenja, me të cilat tregohet automjeti i ndalur në rrugë;*
2. *Gjatë natës dhe gjatë shikimit të zvogëluar për shkak të motit ose kushteve të tjera të pavolitshme të vendosë llambë me dritë dridhëse apo të vazhdueshme me ngjyrë portokalli;*
3. *Të dërgojë bashkëshoferin ose shoqëruesin e dërgesës që të vendosë në distancë prej 100 – 150m prapa automjetit të ndalur - ditën flamurin me të cilin tregohet automjeti që transporton materie të rrezikshme, kurse natën dhe në kushte të shikimit të dobët - llambë.*

Ai duhet të paralajmërojë shoferët të cilët vinë me anën tjetër të rrugë, në të cilën gjendet automjeti i ndalur, në mënyrë që ato automjete me kohë mund të ndalojnë ose të zvogëlojnë shpejtësinë dhe të përgatiten për anashkalim të sigurt të automjetit të ndalur. Shenjat dhe dritat janë të vendosur në distancë prej së paku 50 m nga automjeti, edhe atë që të jenë të dukshme në distancë prej së paku 150 m për drejtuesit e automjeteve motorike që takohem të njëjtën anë të rrugës në të cilën automjeti është ndalur.

Obligimi për personelin vozitës, në rast aksidenti apo incidenti është që menjëherë ta lajmërojë stacionin më të afërt të policisë. Në qoftë se në automjet gjendet vetëm shoferi, atëherë obligimin e tij për lajmërim ia të përcjell preronit tjetër që ndodhet në atë vend. Me këtë rast ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e vendit të aksidentit apo incidentit.




Fig.30. Aksidenti në rrugë gjatë materies së rrezikshme

L I T E R A T U R A

www.adr transport.com

www. adr dokument.com

www. adr wikipedia.com

www. adr accident.com

Hartuesi i këtij punimi është studiues i Komunikacionit Rrugor

Bsc.Erduan RASHICA

